

Albanisch

Të dashur prindër,

në mesimdhënien e fesë katolike ka hapësirë dhe kohë për pyetje të rëndësishme të fëmijës uaj, si “Prej ku”, “Perse” dhe “Për ku”, për origjinën dhe kuptimin e jetës.

Këtu fëmija juaj ka mundësinë të marrë pjesë në një proces eksplorimi stimulues dhe tërheqës. Fëmija mund të bëjë zbulime interesante të besimit katolik, të argumentojë dhe të kuptojë njerëz që mendojnë ndryshe në pyetje fetare e botkuptimore, çfarë kuptojnë kur flasin për “ Zotin” por dhe çfare kuptimi ka për ta “Zoti” çfarë kuptojmë me një jetë të drejtë dhe të mirë si dhe shumë pyetje të tjera.

Ju mund të gëzoheni në familie për shumë bisedime që pasurojnë me eksperinca të shumta fëmijën tuaj.

Në shkollë janë mësueset e mësuesit e fesë që e shoqërojnë fëmijën tuaj dhe qëndrojnë në dispozicion si persona të cilëve mund t'i drejtoheni.

Peshkopi Ivo Muser

Dioqeza Bozen-Brixen

Të drejta themelore

Mësimdhënia e fesë katolike bën pjesë në detyrën formuese të shkollës. Ajo është pjesë e programit në shkollat publike si lëndë e rregullt dhe zhvillohet në bazë të marrëveshjeve me parimet e kishës katolike.

Në lëndën e fesë katolike mund të marrin pjesë, nxënëse dhe nxënës të cilët nuk i përkasin fesë katolike. Në mësimdhënien e fesë katolike janë të mirëpritur të gjithë nxënësit pavarësisht nga feja e tyre. Pjesëmarrja e tyre është pasurim për nxënësit e tjerë në klasë dhe nxit bashkëjetesën paqësore midis tyre.

Në Südtirol/Alto Adige mësimi i fesë i drejtohet të gjithë nxënësve, me përjashtim të atyre të cilëve prindërit ose personi që kujdeset për to vendosin për një mospjesëmarrje të fëmijes në mësim.

Mospjesëmarrja në mesimin e fesë duhet prezantuar në formë të shkruar me anë të një kërkesë në momentin e regjistrimit të fëmijës në shkollë dhe vlen për të gjitha vitet shkollore, me përjashtim të rastit kur prindi vendos të ndryshoje zgjedhjen e tij në fillim të vitit të ri shkollor. Formularët ndodhen në sekretariatë e çdo shkolle.

Nxënëse dhe nxënës të cilët nuk marrin pjesë në lëndën e fesë katolike, kanë të drejtë:

- a) të frekuentojë një ofertë tjetër zhvilluese
- b) të punojnë në mënyrë të pavarur, por nën kontroll
- c) të largohen nga shkolla gjatë kësaj lënde , por vetëm me miratimin e prindërve(prindi duhet të firmosë për këtë lloj vendimi dhe të garantojë që fëmija të kthehet në shkollë brenda orarit të caktuar)

Lidhur me vlerësimin në lëndën e fesë katolike vlejnë të njëjtat rregulla si ato të vlerësimit të nxënësve në lëndët e tjera. I vetmi ndryshim qëndron në faktin që kjo lëndë nuk influencon për kalim e klasës. Kjo do të thotë që një vlerësim pozitiv në lëndën e fesë katolike nuk është i domosdoshëm për të kaluar klasën

Për informacione të mëtejshme është në dispozicionin tuaj “Zyra e katekezës dhe mësimdhënie feje” në numrin e tel: 0471-306205 ose E-mail schule.scuola@bz-bx.net dhe Inspektori për mësimdhënien e fesë në numrin e tel: 0471-417620 ose E-mail: Christian.Alber@schule.suedtirol.it